

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit M. Z., nga P., për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1028-5/2016 të datës 03.06.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Elfete Purova, dhe të akuzuarit, me datë 10.02.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari:

**M. Z.**, nga i ati H. dhe nëna Sh. e lindur K., i lindur me *data e lindjes...* në P. ku edhe jeton në rrugën .... p.n, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i katër fëmijëve, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

Prej datës së pavërtetuar e deri më dt. 01.02.2016, i akuzuari në shtëpinë e tij, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë e shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë që në njëhisor me nr. 1200518364 dy urat matëse të shpenzimit të energjisë elektrike janë të larguara nga foleja /L1,L2/,ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, gjendje kjo e konstatuar sipas procesverbalit me nr. 1405763 të dt. 01.02.2016, nga Qendra kalibrimit Prishtinë, me çka të dëmtuarës KEDS Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike SH.A. Distrikti Prizren, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 709.72 euro.

Këso dore ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 te KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, të akuzuarit ia shqipton:

## DENIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe

## DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të

ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 10 ditë burg

E dëmtuara: KEDS, Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë shumën prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1028-5/2016 të datës 03.06.2016 kundër të akuzuarit M. Z., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës

Prokurori i shtetit Elfete Purova në fjalën e saj përfundimtare deklaron: mbes në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.1028/2016 të datës 03.06.2016, të parashtruar ndaj të pandehurit M. Z., nga P., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS Distrikti në Prizren, B. P., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: që si palë e dëmtuar parashtron kërkesë pronësore juridike në vlerë prej 709,72 Euro.

I akuzuari M. Z., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me aktakuzën të ngritur ndaj meje, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, kam qenë në shtëpi, dhe i kam njoftuar familjarët për arsyen e ftesës në shqyrtim fillestar dhe caktimin e shqyrtimit të sotëm gjyqësor, duke i njoftuar që fjala është për një ndërhyrje në njehsor, dhe nuk e dija se kush dhe kur të ketë ndërhyrë në njehsor. Pas këtij njoftimi djali im më njoftoi që një shokë i tij me kërkesën e tij e kishte ngacmuar – dëmtuar njehsorin, andaj pasi që njehsori është në emrin tim, edhe e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë. Por i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë nga ana ime, sjelljen time korrekte sot para gjykatës, rrethanat e mia familjare pasi që jam person familjar, baba i katër fëmijëve, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, pos të cekurave i njoftoj gjykatën që jam mbajtësi vetëm i familjes, dhe se për momentin jam i pa punë, si dhe sigurimin e ekzistencës të familjes e bëj me punë të kohë pas kohshme. Andaj të gjitha të cekurat më lart, i propozoj gjykatës ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Prej datës së pavërtetuar e deri më dt. 01.02.2016, i akuzuari në shtëpinë e tij, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë e shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë që në njehsor me nr. 1200518364 dy urat matëse të shpenzimit të energjisë elektrike janë të larguara nga foleja /L1,L2/, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, gjendje kjo e konstatuar sipas procesverbalit me nr. 1405763 të dt. 01.02.2016, nga Qendra kalibrimit Prishtinë, me çka të dëmtuarës KEDS Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike SH.A. Distrikti Prizren, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 709.72 euro.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekzistonte ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës .

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, moshën e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i katër fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësore juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1172/2016 me datë 10.02.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**

**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.